



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZP..A.nr.22/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA, në panelin e përbërë nga gjyqtarët Hidajete Gashi Alaj, kryesuese, Kujtim Pasuli dhe Ramush Bardiqi, anëtarë, duke vendosur në lidhje me ankesën e subjektit politik Lëvizja Përparimtare e Romëve të Kosovës, me seli në Prizren, të paraqitur kundër kandidatit Blerim Avdo nga subjekti politik Partia Rome e Bashkuar e Kosovës (PREBK), me seli në Prizren, shkak të shkeljes së dispozitave të Kodit të Sjelljes për subjektet politike, mbështetësit e tyre dhe kandidatët, në zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të cilat do të mbahen me datë 28 dhjetor 2025, me në seancën e panelit të mbajtur, më datë 16.12.2025, merr këtë:

V E N D I M

Hedhet e palejuar ankesa ZP.A.nr.22/2025, e datës 15.12.2025, e parashtruar nga Lëvizja Përparimtare e Romëve të Kosovës, me seli në Prizren, kundër kandidatit Blerim Avdo nga subjekti politik Partia Rome e Bashkuar e Kosovës (PREBK), me seli në Prizren, për shkak të shkeljes së dispozitave të Kodit të Sjelljes për subjektet politike, mbështetësit e tyre dhe kandidatët, në zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen me datë 28 dhjetor 2025.

A r s y e t i m

PZAP-i më datë 15.12.2025, ka pranuar ankesën ZP.A.nr.22/2025, nga subjekti politik Lëvizja Përparimtare e Romëve të Kosovës, me seli në Prizren, paraqitur kundër kandidatit Blerim Avdo nga subjekti politik Partia Rome e Bashkuar e Kosovës (PREBK), me të cilën pretendon se kandidati numër 8 në zgjedhjet e 28 dhjetorit nga subjekti politik PREBK, Blerim Avdo, me datë 13 dhjetor 2025, në rrjetin social Facebook, në storie 24 orëshe, ka postuar shkrime me përmbajtje denigruese, me qëllim të dëmtimit të reputacionit të ish deputetit dhe kryetarit të subjektit politik Lëvizja Përparimtare e Romëve të Kosovës, Erxhan Galushi, pikërisht në prag të zgjedhjeve të 28 dhjetorit 2025. Prandaj, duke e parë se këto postime kanë për qëllim degradimin e integritetit të ish deputetit dhe garuesit për zgjedhjet e 28 dhjetorit, kanë konsideruar se këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme nr. 08/L-228, përkatësisht neni 33 paragrafi 1, 4 dhe 5. Ankesës i ka bashkëngjitur fotografi të postimit.

Në përgjigje në ankesë të dorëzuar me datë 15.12.2025, nga subjekti politik Partia Rome e Bashkuar e Kosovës ka theksuar se, në llogarinë sociale në Facebook të Blerim Avdo nuk është postuar asnjë shkrim me përmbajtje denigruese ndaj askujt, Facebook-u ku pala ankuese ka paraqitur si provë, janë screenshot dhe nuk figuron data kur është realizuar ky postim. Tutje ka theksuar se duke u bazuar në vendimin e KQZ-së mbi miratimin e planit operacional të zgjedhjeve në të cilën fushata zyrtare fillon me 17 dhjetor 2025, subjekti politik PREBK konsideron se nuk ka asnjë shkelje të kodit të sjelljes për subjekte politike, mbështetësit e tyre dhe kandidatet. Nuk vërehet se ka emra të potencuar të kandidatëve apo kryetarit të subjektit politik siç pretendon pala ankuese. Kanë kërkuar nga PZAP që ta hedh si të pabazuar në prova ankesën e subjektit politik LPRK.

Paneli zgjedhor për ankesa dhe parashtresa, pas shqyrtimit paraprak të ankesës, dhe shkresave të lëndës vlerëson se:

Ankesa është e palejuar.

Paneli vlerëson se pretendimi i palës ankuese, që i referohet shkeljeve të dispozitave të Kodit të Mirësjelljes për subjektet politike, mbështetësit e tyre dhe kandidatët është e palejuar për faktin se me vendimin e KQZ-së nr.01/3635/2025 të datës 04.12.2025, Miratimi i Planit Operacional të Sigurisë për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës 2025, është Miratuar Plan Operacional i Sigurisë, për zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të cilat do të mbahen me datë 28 dhjetor 2025, që do të thotë se, fushata zgjedhore fillon më datë 17.12.2025 dhe përfundon 28.12.2025. Meqenëse në aspektin kohor, faza e procesit zgjedhor kur parashtrohet ankesa është para fillimit të fushatës zgjedhore, ankesa e ankuesit duhet të hedhet poshtë si e palejueshme, për shkak se e njëjta është paraqitur para fillimit të fushatës zgjedhore.

Sipas nenit 32 të LZP parashihet që: “Kodi i Sjelljes për subjektet politike dhe mbështetësit e tyre dhe kandidatët ka për qëllim krijimin e kushteve në të cilat populli i Kosovës mund të zgjedhë përfaqësuesit e tij përmes zgjedhjeve të lira, të drejta dhe të mirë-informuara në një atmosferë të tolerancës demokratike, paqes dhe respektit për sundimin e ligjit.” Me dispozitën e nenit 33.1 të LZP është paraparë që: “Këtij Kodi i detyrohen të gjitha subjektet politike, kandidatët, anëtarët e subjekteve dhe mbështetësit e tyre”.

Me dispozitën e nenit 115 të LZP-së parashihet që: “PZAP është organ i përhershëm i pavarur kompetent për të vendosur në lidhje me ankesat e lejuara që kanë të bëjnë me procesin zgjedhor siç është caktuar me këtë ligj dhe rregullat zgjedhore.”

Me dispozitën e nenit 118.1 të LZP-së, i cili përcakton se: “PZAP-i, pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk i përmbushin kriteret e miratuara paraprakisht”, dhe neni 13.3 të Rregullores Nr.01/2025 për Procedurat e Parashtrimi dhe Vendosjes së Ankesave të

PZAP-it, në të cilin përcaktohet se: “PZAP-i, e hedhë ankesën kur vlerëson se ajo nuk përmbush kërkesat e LZP-së dhe kësaj rregullore për shqyrtim”.

Bazuar në lartcekura si dhe dispozitat ligjore, me të cilën përcaktohen veprimet e ndaluara të subjekteve politike, gjatë periudhës së fushatës zgjedhore si dhe duke pasur parasysh, se pretendimet ankimore të parashtruara në ankesë nga pala ankuese janë zhvilluar para datës zyrtare të caktuara nga KQZ për fushatën zgjedhore e cila fillon më datë 17.12.2025 dhe përfundon 28.12.2025, Paneli vlerëson se, ankesa e ankuesit është e palejuar, ngase me dispozitat e LZP-së dhe me rregullat zgjedhore nuk është paraparë sanksionimi apo marrja e masave tjera ligjore për këtë periudhë të para fushatës zgjedhore.

Andaj, nga arsyet e theksuara më lartë, e në kuptim të nenit 118.1 të LZP-së nenit 13.3 të Rregullores Nr.01/2025 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-it, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
ZP.A.nr.22/2025 datë 16.12.2025

Kryesuese e panelit
Hida Jete Gashi Alaj



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.